



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 08.07.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të komisionit datë 06.07.2016
2. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen i projektligjit “Për Statusin e Gjyqtarit dhe Prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmata.

**Mungon:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Agnes Bernhard – eksperte e Nivelit të Lartë, zëvendëssefe e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit me vazhdimin e projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”. E kemi lënë te neni 105, “Parimet e procedimit disiplinor”.

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt do të them dy fjalë për ta lehtësuar edhe punën. I gjithë ky kapitull është riparë dhe është punuar së bashku me ekspertët, ku kemi bërë disa riformulime, më tepër në unifikimin e gjuhës dhe në pastrimin e fjalëve të tepërta. Lidhur me nenin 105 “Parimet e procedimit disiplinor”, ka vetëm një riformulim në pikën “d” dhe në paragrafin e dytë ku kemi evidentuar qartë mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha rastet kur ka procedim disiplinor dhe do të duhet të nxirren ose të botohen të dhënat. Gjëra të tjera lidhur me këtë nen nuk ka, janë thjesht rregullime dhe saktësime terminologjie.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Agnes.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)*Jo, nuk kam gjë, faleminderit!

**Vasilika Hysi** - ... e kemi bërë edhe sot madje në mëngjes dhe është termi i shkeljeve disiplinore për pakujdesitë e rënda. E kemi diskutuar me zonjën Agnes dhe grupi i punës paska pasur një debat nëse do të ketë përgjegjësi disiplinore vetëm për veprat e kryera me dashje apo nga pakujdesia dhe është konkluduar që duhet të jetë për pakujdesi të rëndë dhe për formën e dashjes, pra kemi fshirë dashjen e rëndë dhe për çdo formë dashjeje do të ketë përgjegjësi disiplinore.

Shqetësimi ynë, zoti kryetar është, që ne në terminologjinë tonë për pakujdesinë nuk kemi ndonjë ligj të veçantë ku të thuhet pakujdesi e lehtë dhe pakujdesi e rëndë, ndërkohë që përvoja europiane paska rregulla dhe specifike për ta bërë këtë dallim. Ndoshta në të ardhmen do të duhet që të përcaktojmë se kur do të quhet pakujdesi e rëndë ose pakujdesi e lehtë. Zonja Agnes, madje ka një sugjerim madje për këtë çështje, për të cilën ne kemi diskutuar gjatë, por nuk kemi gjetur një zgjidhje.

**Agnes Bernhard** –*(flet anglisht)* Për momentin ligji juaj parashikon një kategorizim për shkeljet që janë serioze, më pak serioze dhe më të rënda. Kjo nuk është shumë efikase, sepse nuk është shumë e saktë dhe çdo akt apo secili akt që mund të bëhet në rrethana të caktuara, mund të

ketë rezultate më serioze ose më pak serioze, më të rënda ose më pak të rënda. Ka pasur një diskutim të gjerë nëse një katalog specifik për këto shkeljet më të rënda, më të lehta e me radhë do të ishte i përshtatshëm dhe ne vendosëm të mos zgjedhim një kategorizim shumë strikt, por t'i listojmë të gjitha këto shkelje, dhe më pas i mbetet këshillit t'i marrë parasysh kur të vijë momenti, për të përcaktuar nëse një akt është shumë i rëndë, më pak i rëndë ose më i lehtë.

Për shembull, nëse unë pranoj një dhuratë, mund të them që kjo është diçka gjithmonë shumë e rëndë, por rrethanat mund të tregojnë që kam pranuar një kafe nga një person për të cilin nuk e dija që mund të ishte i përfshirë në një procedim gjykatë dhe kjo nuk është diçka shumë e rëndë. Pra, mbetet që për çdo rast të kemi një përcaktim të caktuar dhe ligji duhet të përcaktojë një sërë faktorësh që duhen marrë parasysh, për të pasur këtu edhe argumentimin dhe kur të vijë momenti për përcaktimin e sanksioneve.

Gjithashtu, do të jetë kjo listë që do të thjeshtësojë përcaktimin e proporcionalitetit që kërkon që sanksioni të jetë në përpjesëtim në raport me seriozitetin ose rëndësinë e aktit, se sa i rëndë ose sa i lehtë është ai.

**Fatmir Xhafaj** – Në vlerësimin tim kjo është një gjë më e pranueshme, duke i lënë mundësi këshillit që rast pas rasti ta çmojë dhe më pas kjo do të çeli edhe praktikën, për shkak se ne kemi një praktikë të kufizuar në shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre. Pra, me krijimin e praktikës ndoshta mund të jetë pastaj e nevojshme për t'i definuar gjërat edhe në ligj dhe për të krijuar institute më të qarta.

Atëherë, dakord?

Faleminderit, me ndryshimet!

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, te pika 2 kemi bërë një riformulim, por do të kërkoja nga zonja Agnes që ta mbajë parasysh se kush quhet magjistrati mesatar. Këtu thuhet se pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur...

**Fatmir Xhafaj** – Po ramë dakord me ndryshimin që keni bërë këtu.

**Vasilika Hysi** – Magjistrati mesatar...

**Fatmir Xhafaj** – E lamë te neni 106.

Dakord.

**Vasilika Hysi** – Pjesa tjetër janë riformulime në nenin 106.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Anges, lidhur me konceptin e mesatarizimit?

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Koncepti është që sigurisht çdonjëri bën gabime gjatë ushtrimit të detyrës, por jo çdo gabim që ndodh gjatë ushtrimit të detyrës mund të konsiderohet si një shkelje disiplinore dhe kjo është gjithmonë një kufi shumë i vështirë për t’u përcaktuar. Pra, për të përcaktuar nëse gabimi i bërë nga ky gjykatës është një shkelje ose jo, dhe këtu mund t’i referohemi, për shembull një gjykatësi, i cili nuk është shumë i aftë, pastaj vjen koncepti se çfarë mund të pritët nga një situatë e tillë në shkeljet që mund të ndodhin, nëse shkeljet janë të rënda, atëherë këto janë brenda përgjegjësisë disiplinore. Mund të ndodhë që në vendimmarrje një gjykatës voton për një të dhënë gabimisht, nëse kjo është një e dhënë që nuk është shumë e rëndësishme, sepse mund t’u ndodhë të gjithëve të bëjnë një gabim, por nëse referohet me diçka që është subjekti dhe ana esenciale e vendimit, atëherë kjo bëhet shumë serioze dhe e rëndësishme dhe shkelja disiplinore këtu është e parashikueshme.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 106 së bashku me ndryshimet?

Neni 107 “Shkeljet disiplinore në lidhje me funksionin”.

**Vasilika Hysi** – Te neni 107 ka vetëm riformulim të paragrafit të parë. Gjithashtu, në paragrafin e dytë ka riformulim fjalësh ose plotësim i ndonjë fjale të munguar. Njëkohësisht te paragrafi i dytë në germën “f” kemi rregulluar ose kemi unifikuar terminologjinë për përcaktimin e gjykatave të posaçme, për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe të korrupsionit, pra me gjuhën e Kushtetutës. Në paragrafët 3 dhe 4 nuk ka ndryshime, por ka vetëm ndonjë saktësim drejtshkrimor. Ky është një nen shumë i rëndësishëm zoti kryetar, pasi ka bërë për herë të parë përcaktimin e shkeljeve disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit në mënyrë shumë të detajuar, duke i dhënë mundësinë çdo magjistrati të dijë mirë se cilat nga veprimet apo mosveprimet e tij përbën shkelje, sipas përcaktimeve që bëhen në nenin 106 të ligjit.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, dakord me ndryshimet?

Keni ndonjë gjë për ndryshimet?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Ndoshta vetëm duhet të kemi parasysh këtë shtesën, pra që qëllimi i këtij neni nuk është që të ketë një listë shteruese të të gjitha shkeljeve, por ky si nen në vetvete parashikon rastet që edhe sikur edhe një shkelje të mos jetë brenda listës së parashikueshme, akti edhe pse nuk mund të mos jetë parashikuar shprehimisht aty në listë mund të bëjë pjesë në familjen e njërës prej këtyre parashikimeve të shkeljeve që parashikohen këtu, edhe pse mund të mos jetë shprehimisht e shprehur në parashikimet e nenit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord për nenin 107 me ndryshimet? Po.

Neni 108, “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”.

**Vasilika Hysi** – Edhe te ky nen, zoti kryetar, është e njëjta logjikë si te neni 107, nuk është një listë ezauroese, pasi në paragrafin e parë thuhet: “Në veçanti aktet dhe sjelljet si vijon”. Pra, mund të ketë akte dhe sjellje të tjera që mund t’i krijojë praktika gjyqësore dhe vetë këshilli nëpërmjet rasteve *case law* që do të krijojë. I vetmi ndryshim i vogël është te pika “dh” ku thuhet se çdo lloj shkeljeje e kryer të paktën edhe nga pakujdesia, shkelje të detyrimeve të ligjit. E njëjta gjë edhe për nenin 109, pasi shkeljet disiplinore vazhdojnë, për shkak të kryerjes së veprës penale, është e njëjta logjikë si me nenin 107 dhe me nenin 108. Nuk ka probleme.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin?

Neni 109 “Shkeljet disiplinore...”

**Vasilika Hysi** – Edhe këtë e thamë, është në rregull.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 110 “Masat disiplinore”

**Vasilika Hysi** – Neni 110 është një risi, pasi ka disa lloj vërejtjesh dhe masash që jepen. I vetmi ndryshim është në pikën “ç” ku kemi unifikuar përcaktimin që u bëhen gjykatave të posaçme, pra gjykatave antikorrupsion dhe krimin të organizuar me formulimin që ka Kushtetuta. Pjesa tjetër është korrekte.

**Fatmir Xhafaj** – Përputhshmërinë me projektin. Në rregull.

Dakord neni 110 me ndryshimin?

Neni 111 “Vërejtje konfidenciale”.

**Vasilika Hysi** – Ka vetëm redaktime të 2-3 fjalëve, ndërsa përmbajtja është e saktë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 112 “Vërejtje publike”.

**Vasilika Hysi** – Vërejtja publike nuk ka probleme, është e saktë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 113 “Ulja e pagës”.

**Vasilika Hysi** – Është e saktë, vetëm kemi saktësuar gjithandej fjalën ku thuhet “masë”, “masë disiplinore” për ta dalluar nga masat e tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Vasilika Hysi** – Ose kur thuhet “shkelje”, “shkelje disiplinore” për ta dalluar nga shkeljet penale e të tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 114 “Ulja në detyrë”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka vetëm një përafrim me terminologjinë që vendosëm në ndryshimet kushtetuese për gjykatat e posaçme.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 115.

**Vasilika Hysi** – Neni 115 nuk ka probleme, është sipas projektit.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 116 “Shkarkimi”.

**Vasilika Hysi** – Këtu te “Shkarkimi” ka uniformitet të terminologjisë me projektin kushtetues, njëkohësisht kemi pasur një ndryshim në pikën “b” ku thuhet se në cilat raste këshilli vendos për shkarkimin, kur është kërkuar të ketë, përsëri diskutimi që bëme me zonjën Agnes, pakujdesi në formën e rëndë dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Për fjalën “prokurorialin” nuk kemi gjetur ende fjalën për ta zëvendësuar.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord për nenin 116 me ndryshimet.

Neni 117 “Masat disiplinore plotësuese”.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, këtu kam një pyetje për zonjën Agnes. Këtu thuhet: “Këshilli vendos masë disiplinore plotësuese krahas masës disiplinore”. dhe “Në rastin e shkarkimit, mbahet 50% e vlerës së dy vjetëve pasues”. Kur thuhet “2 vjetëve pasues”, cili është kuptimi? A është për vitet e mëparshme? Pra, në rastet kur ndaj gjyqtarit është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë për korrupsion krahas shkarkimit atij i mbahet 50% e pagës.

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Do të sugjeronim ta heqim pjesën e muajit dhe kështu me radhë, pasi kjo nuk është e rëndësishme. E rëndësishme është që ai duhet të kthejë 50% të pagesës për dy vjetët e karrierës së tij, pas heqjes nga puna.

**Vasilika Hysi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 118 “Masat plotësuese”.

**Vasilika Hysi** – Është thjesht një riformulim i fjalisë së parë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 119, “Ulja në detyrë e kryetarit”

**Vasilika Hysi** – Përsëri është një riformulim i fjalisë së parë.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo do të quhet ulje në detyrë, apo largim nga detyra?

**Vasilika Hysi** – Kjo është ulje në detyrë, nga kryetar shkon magjistrat i thjeshtë.

**Fatmir Xhafaj** – Të largohet nga detyra e kryetarit..

**Vasilika Hysi** – Ju thoni për të pasur edhe shkarkimin?

**Fatmir Xhafaj**– Nuk është një ulje nga kryetar në zëvendëskryetar. Nuk është detyrë e re magjistrati, është funksioni i tij bazë.

**Vasilika Hysi** - Largimi nga funksioni, se nga detyra ikën si kryetar. Diskutimin ne e kemi bërë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, shiheni këtë gjë!

Neni 120, “Kriteret për caktimin e masës disiplinore”.

**Vasilika Hysi** – Eshët e saktë. Më vjen mirë që në ligj do të ketë kriteret transparente, të cilat do të quhen rrethana rënduese dhe lehtësuese. Kjo është një gjë shumë e mirë që kanë bërë.

**Fatmir Xhafaj** – Më vjen shumë mirë, se ka qenë një nga problemet më të mëdha. Edhe kur ka pasur vullnet për ta trajtuar masën disiplinore, ka pasur interpretime të ndryshme.

Neni 120. Dakord.

Neni 121 “Masat për shmangien e vonesave”.

**Vasilika Hysi** – Te neni 121 kemi bërë një riformulim. Kemi shmangur dispozitat. Është sugjerimi im, të mos themi sipas neneve 350 dhe 351, por themi: “Në rastet e deklarimit në mungesë apo procedimit ...” Nuk themi nenet, se mund të ndodhë që nenet të kenë ndryshime, por të paktën themi thelbin e problematikës.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me ndryshimin.

Dakord me nenin 122, “Procedurat hetimore, afatet e shkarkimit”

Neni 123.

**Vasilika Hysi** – Po. Këto janë afatet e procedimit të zyrës së inspektoratit. Ka një risi në ligj. Është për t’u përsëritur që inspektorati ka afate, se kur duhet të vendosësh fillimin e marrjes së vendimit për hapjen e hetimit dhe kur duhet të arkivojë. Kjo është një gjë shumë e mirë, pasi nuk e lë në afatet dhe kalendat greke, siç është sot, që do gati një vit që të fillojë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 124.

**Vasilika Hysi** – Ndryshimet janë redaktoriale.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 125.

**Vasilika Hysi** – Te neni 125, “Kriteret e pranueshmërisë së ankesës”, kemi riformulime të teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 126 “Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës”.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord me përmbajtjen, por thjesht kemi plotësime të referencave në paragrafët e nënve të këtij ligji për të qenë më të qartë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet.

Neni 127, “Verifikimi i ankesës”.

**Vasilika Hysi** – Përsëri këtu ka riformulime të teknikës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 128.

**Vasilika Hysi** – Ky nen ka disa riformulime që lidhen me teknikën legislative për ta bërë përmbajtjen më të shkurtër, sidomos pika 2 është me rëndësi, ku thuhet që inspektori merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të këtij procesi gjyqësor administrativ në lidhje me të njëjtin fakt.

Kemi pasur një diskutim. Zonja Agnes pranon që duhet të jetë e mirëkoordinuar veprimtaria e inspektorit të lartë të drejtësisë për fillimin e hetimit, pavarësisht nëse ka një proces të tillë apo jo.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin.

Neni 129.

**Vasilika Hysi** – Edhe te neni 129 flitet për fillimin e hetimit kryesisht. Ka thjesht një riformulim.

I vetmi problem që kemi, zoti kryetar, për të cilin duhet të biem dakord, dhe ju duhet ta keni parasysh me të gjithë grupet, është se këtu është përdorur shpesh shprehja “për aq sa është e mundur”. Ndërkohë, kemi pasur një diskutim shumë të gjatë dhe me ekspertët, sidomos me zonjën Agnes. Për rregullat që parashikohen në ligj nuk mund të thuhet: “Të zbatohen për aq sa është e mundur”. Ato duhen zbatuar siç janë. Zonja Agnes ka një merak dhe do të shprehet për këtë.

**Agnes Bernhard-** (*flet anglisht*) Termi që përdoret në variantin anglez është një term latin, që do të thotë se parashikimet do të zbatohen në kontekstin me të cilin ajo do të përkojë. Duhet të zbatohet, por duhet të jetë në përputhshmëri me kontekstin përkatës. Pra, është një problematikë e veçantë kjo për të gjetur terminologjinë e duhur në shqip, për të mos e lënë të gjerë interpretimin e saj, por për të përcaktuar që ajo aplikohet për aq kohë sa ajo është e



përshtatshme me rrethanën konkrete. Kjo mbetet një çështje e terminologjisë shqiptare për t'i dhënë kuptim sa më të plotë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 13 “Zgjerimi ose ndryshimi hetimit”.

**Vasilika Hysi** – Te neni 130 ka thjesht riformulime të teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 131, “Pezullimi i hetimeve”.

**Vasilika Hysi** - Te neni 131 ka thjesht riformulime të teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 132, “Kërkesat për pezullimin e magjistratit”,

**Vasilika Hysi** – Këtu kemi riformulimin e e fjalisë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 133, “Bashkimi i procedimeve”.

**Vasilika Hysi** - Këtu kemi shtuar fjalët “Bashkimi i procedimeve hetimore” që në titull.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 134, “Të drejtat dhe detyrimet e magjistratit gjatë hetimit”.

**Vasilika Hysi** – Është saktësuar se ku fillon të konsiderohet magjistrati palë në proces “që nga momenti i fillimit të hetimit”. Me të drejtë me zonjën Agnes e kemi diskutuar gjatë për të thënë që në momentin kur inspektori bën verifikimin e fakteve dhe të dhënave, personi nuk është palë në proces; në momentin që inspektori merr vendim për fillimin e hetimit, magjistrati është palë në proces dhe i garantohet aksesit në dosjen e hetimit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 134 me ndryshimet që janë bërë.

Neni 135 “Ecuria e hetimeve”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka riformulime të teknikës legjislative në paragrafët 1, 2 dhe 3.

**Fatmir Xhafaj** – Gjeneroj një fjalë tjetër se ky është procedim. “Procedimi i hetimeve”.

**Vasilika Hysi** - A mund të ketë një term tjetër, sepse edhe zoti Majko edhe zoti Xhafaj preferojnë një term tjetër?

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Gjithçka që shpreh më mirë përmbajtjen do të ishte më e gjetur.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 136, “Kërkesat për marrjen në pyetje”.

**Vasilika Hysi** – Në këtë nen kemi bërë disa riformulime për të bërë të qartë procedurën dhe kërkesat, kriteret që duhet të përmbushen për marrjen në pyetje. Është shumë i rëndësishëm regjistrimi, audio -video. Janë ndryshime të karakterit teknik.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 137, “Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave”.

**Vasilika Hysi**- Nuk ka gjë. edhe këtu kemi ndonjë riformulim gjuhësor.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 138, “Dokumentacioni i hetimit”.

**Vasilika Hysi**- Nuk ka gjë. Edhe janë rregullime të teknikës legislative, janë riformulime konform rregullave.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 139, “Mbyllja e hetimit”.

**Vasilika Hysi**- Edhe këtu kemi riformulim, të teknikës legislative gjuhësor, kryesisht të germave “b”, “c”, “ç” dhe te paragrafi i dytë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 140, “Marrëveshja e pëlqimit e përbashkët”.

**Vasilika Hysi**- Edhe këtu ka thjesht ndonjë riformulime të teknikës legislative. Është një risi që ka marrëveshje që diskutojnë palët.

**Fatmir Xhafaj** – Është si tipi i *pattigliamento*-s italiane. Pse nuk e fusni edhe këtë në Kodin e Procedurës Penale?

**Vasilika Hysi** – Më duket se është edhe në Kod.

**Agnes Bernhard**- (*flet anglisht*) Është propozuar në Kodin e Procedurës së projektligjit. Ajo që ka bërë grupi i punës në këtë parashikim është se, nëse Kodi i Procedurës Penale nuk e përfshin, atëherë do ta kalojmë te Kodi Disiplinor.

**Fatmir Xhafaj** – Kodi i Procedurës italiane e ka shumë të zhvilluar. Juli, si avokat që ka studiuar në Itali, e di shumë mirë.

**Vasilika Hysi** – Zonja Agnes, grupi i punës ka bërë një shënim në footnote që, në rast se nuk parashikohet në Kodin e Procedurës Penale, duhet hequr edhe prej këtej.

Por nga ana tjetër, paketën e ndryshimeve kushtetuese me 7 ligjet kryesore nuk e kalojmë në të njëjtën kohë me Kodin e Procedurës Penale.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Agnes Bernhard**– (*flet anglisht*) Mund ta lini. Gjithsesi është një vendimmarrje politike. Mund ta shqyrtoni brenda grupit të punës më vonë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 141, “Referimi i çështjeve në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

**Vasilika Hysi** – Është vetëm riformulimi i teknikës legislative.

**Fatmir Xhafaj** - 142, “Sistemi i menaxhimit të çështjeve”.

**Vasilika Hysi** - Nuk ka probleme. Janë thjesht çështjeje të teknikës legislative.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 143, “Fillimi i procedurës disiplinore”.

**Vasilika Hysi** – Këtu kemi bërë rregullime lidhur me fillimin e procedurës disiplinore, lidhur me njoftimin e palëve për të garantuar kohë të mjaftueshme dhe mua më duket e drejtë që në fillimin e një procesi disiplinor, palët do të kenë të drejtë të paktën të kenë disa ditë kohë të përgatiten, të njihen me faktet dhe këtu kemi bërë disa ndryshime lidhur me saktësimin e afateve dhe procedurave.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 144, “Pushimi i kërkesës pa seancë dëgjimore”.

**Vasilika Hysi** – Kemi bërë një ndryshim, kemi thënë: “Refuzimi i kërkesës pa seancë dëgjimore”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

*(Ndërhyrje në gjuhën angleze.)*

Në qoftë se është e saktë, zonja...

**Fatmir Xhafaj** – Po, e keni titulluar ju “Refuzimi i kërkesës pa seancë dëgjimore”. Në rregull?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Edhe zonja Agnes është dakord me nenin 144, me ndryshimin.

Neni 145?

**Vasilika Hysi** – Është në rregull, ka vetëm...

**Fatmir Xhafaj** – Bashkimin e procedimeve.

**Vasilika Hysi** – Po, bashkimin e procedimeve. Do të hiqet një fjalë që është parazite.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, me ndryshimet.

Neni 146 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor”.

**Vasilika Hysi** – Është thjesht për redaktim gjuhësor.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 147 “Seanca disiplinore”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka vetëm redaktim të teknikës legislative.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 148 “Shtyrja e seancave”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka redaktime. Janë hequr fjalët e tepërta.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Vazhdojmë me nenin 149, që është “Ndryshimi ose zgjerimi i objektit të procedimit disiplinor”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu është thjesht redaktim i teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me to.

Neni 150 “Pezullimi i procedimit disiplinor”.

**Vasilika Hysi** – Është në rregull, ka vetëm një referencë më të saktë, jo te neni 136, por te neni 131. Pra, është saktësuar referenca.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 151 “Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës”.

**Vasilika Hysi** – Përmbajtja është në rregull, është bërë vetëm riformulimi i pikës 1, i paragrafit.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, shumë dakord.

Neni 152 “E drejta e ankimit për vendimet disiplinore”.

**Vasilika Hysi** – Këtu kemi shtuar të vetmen gjë, që t’ia bëjmë të qartë se ku ka të drejtë magjistrati të ankimojë një vendim për masën disiplinore. Megjithëse ka një ligj, thotë zonja Agnes, që ne e kemi në diskutim, ligji “Për qeverisjen”, ku përcaktohet rregulli i përgjithshëm: të gjitha vendimet e këshillit ankimohen në gjykatën kompetente, që është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po, patjetër.

**Vasilika Hysi** – Unë kërkoja që të theksohet “në gjykatën kompetente” këtu, pastaj për afatet dhe gjithçka tjetër, në mënyrë të detajuar, i referohemi ligjit përkatës.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, neni 152 miratohet, me ndryshimin.

Vazhdojmë me nenin 153 “Ekzekutimi”.

*(Shkëputje, kalohet në zërin nga kabina në gjuhën angleze.)*

**Vasilika Hysi** – ... nga detyra.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, me ndryshimin.

Neni 154 “Publikimi i vendimeve disiplinore”. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Po, edhe këtu ka rregullime. E vetmja gjë që do të shtohet, te paragrafi i parë do të themi: “Në faqen zyrtare të internetit”, pra duhet të jetë...

**Fatmir Xhafaj** – Neni 155 “Regjistri dhe të dhënat disiplinore”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu, zoti kryetar, kemi thjesht redaktime vetëm te pikat 1 dhe 2.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 156 “Pezullimi i detyruar”.

**Vasilika Hysi** – Te “pezullimi i detyruar” ka thjesht redaktime gjuhësore.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 157 “Pezullimi mbi bazë diskrecioni”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu kemi bërë qartësim të gjuhës, të paragrafit të parë kryesisht dhe të paragrafit 2.

**Fatmir Xhafaj** – Po, i shoh. Në rregull, dakord.

Neni 158 “Fillimi i procedimit të pezullimit”.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka ndryshime, thjesht kemi hequr fjalët “në bazë të diskrecionit”, sepse kur thuhet “neni 157” kuptohet se përse bëhet fjalë, është pezullimi mbi bazë diskrecioni.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 159 “Njoftimet për këshillin”.

**Vasilika Hysi** – Është e njëjta gjë, kemi shtuar fjalën “magjistrat”, për të ditur se ndaj kujt fillojnë hetimet, në mënyrë që të jetë e qartë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 160 “Vendimet e pezullimit dhe ankimet”.

**Vasilika Hysi** – Është thjesht riformulim i paragrafit të dytë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 161 “Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit”.

**Vasilika Hysi** – Këtu kemi shtuar referencën te neni 157.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 162 “Pezullimi i pagës dhe i përfitimeve të tjera”.

**Vasilika Hysi** – Nenin 162 e kemi pothuajse riformuluar për ta qartësuar më mirë. Bëhet fjalë për ndalesën e pagës, që bëhet deri në 50%.

**Fatmir Xhafaj** – A bien dakord ekspertët me riformulimin?

**Agnes Bernhard** –(flet anglisht) Po.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, faleminderit!

Neni 163 “Përgjegjësia penale e magjistratëve”.

**Vasilika Hysi** – Kemi bërë një riformulim. Kemi hequr fjalën “mund”, sepse ne themi: “Magjistrati ndiqet penalisht”, nuk mund të themi: “mund...”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, me ndryshimin.

Neni 164 “Kufizimi i përgjegjësisë civile”.

**Vasilika Hysi** – Është riformulim, ai problemi që diskutuam: neglizhencë e rëndë ose jo e rëndë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, me riformulimin.

**Vasilika Hysi** – Tani është radha e dispozitave të fundit kalimtare.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

Neni 165.

**Vasilika Hysi** – Në përgjithësi dispozitat kalimtare garantojnë vazhdimësinë e institucioneve deri në krijimin e institucioneve të reja. Nuk ka gjë për dy institucionet kompetente, pra për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, ato do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Unë pata një shqetësim dhe ia ngrita zonjës Agnes: periudha e ngritjes së dy komisioneve, zoti kryetar, është e gjatë, gati 8 muaj nga miratimi i këtij ligji...

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – ...ndërkohë që në Kushtetutë dhe me ligj të veçantë ne kemi parashikuar procesin e rivlerësimit.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë problemi kemi nëse ky ligj hyn në fuqi pak muaj... domethënë, jo 15 ditë, por shkon 4-5 muaj. Çfarë problemi krijohet? Pra, që të hyjë njëkohësisht në fuqi me ngritjen e këshillave të rinj dhe të vazhdojnë sot..., sepse kjo do t’i japë mundësi edhe qeverisë për buxhetin e të tjerë, domethënë, edhe ata do të kërkojnë pak kohë për aktet nënligjore.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në fakt, ky është një vendim i cili duhet të merret, është një vendim politik kur ju kërkoni që të filloni t’i zbatoni këto rregulla.

Grupi i punës mendon se do të ishte më mirë, meqenëse ai përcakton rregulla më të qarta dhe kërkesa më transparente për çështjet që lidhen me ngritjen në detyrë, transferimin...

Këshilli i vjetër, gjithashtu, do të fillojë menjëherë ta zbatojë këtë ligj, sepse ky ligj mendohet të vendosë standarde më të mira. Do të ishte më mirë që të fillonim ta implementonim këtë sa më shpejt të jetë e mundur, ky është arsyetimi pas këtij ligji.

Në parim mund të fillojë të implementohet në një shtrirje më të gjerë, por problemi është se këtu dhe atje mund të kemi rregulla të përgjithshme, që janë të nevojshme, pse jo, të mos ishte mundësia që të fillonim dhe t'i përgatisnim këto akte nënligjore derisa ligji të hyjë në fuqi. Ky ligj, gjithashtu, parashikon emërimin për strukturat antikorrupsion, pra çdo gjë duhet të jetë e përgatitur. Për më tepër, ky ligj përmban edhe procedurën e vlerësimit, që është mjaft e nevojshme për rivlerësimin, si dhe, të paktën, kapitulli i rivlerësimit është i nevojshëm që të ekzistojë për periudhën transitore.

**Fatmir Xhafaj** – ...me radhë, që ju të keni mundësi që të shikoni se cilat janë afatet që nuk e dëmtojnë procesin e rivlerësimit e të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 165, dakord, duke e lënë të hapur.

Neni 166?

**Vasilika Hysi** – Edhe neni 166 ka disa dispozita, parashikime për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kryetarin e Gjykatës së Lartë, të cilit i shtohet mandati prej dy vjetësh, do të qëndrojë shtesë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Mund të mos ndodhë vetëm kur i mbaron mandati.

Patëm një diskutim me ekspertët për arsyen pse shtyhet mandati i kryetarit të gjykatës dhe zonja Agnes parashitroi disa argumente, të cilat është mirë t'ia bëjë prezent komisionit edhe këtu.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Agnes.

**Agnes Bernhard** –*(flet anglisht)* Arsyetimi i grupit të punës ka qenë që ndryshimi i institucioneve, dhe në përgjithësi rivlerësimi i të gjithë gjyqtarëve, do të krijonte shumë pasiguri brenda institucioneve.

Sipas nesh do të ishte mirë ose do të ishte diçka e mençur nëse funksionet zgjedhëse për të gjithë këtë periudhë transitore të ekzistojnë akoma, me qëllim që të sigurojmë edhe vazhdimësinë e sistemit gjatë kësaj periudhe të një ndryshimi kaq të madh në sistem. Megjithatë, nëse një kryetar rivlerësohet dhe nuk e kalon rivlerësimin, atëherë ai menjëherë duhet të largohet. Pra, sido që të jetë, ai duhet të largohet.

**Fatmir Xhafaj** – ...i Gjykatës së Lartë, se nuk është për të gjithë kryetarët e gjykatave.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)*Po.

**Fatmir Xhafaj** – Po që se është, mua më duket i arsyeshëm.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Po, konfirmoj që është vetëm për këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 166 dakord, me ndryshimet.

Neni 167 “Dispozitat...”.

**Vasilika Hysi** – Ju lutem shumë, shikoni pak pikën 4 të nenit 166, pasi ju e dini që tashmë në gjykatë do të ketë gjyqtarë dhe jogjyqtarë me status. Këtu është përcaktuar që gjyqtarët në detyrë (që janë zgjedhur aktualisht nga Kuvendi nga radhët e gjyqtarëve) konsiderohen gjyqtarë të ngritur në detyrë, kurse gjyqtarë në detyrë (të zgjedhur nga Kuvendi) do të quhen kandidatët jogjyqtarë sipas këtij ligji. Pra, çdo lloj plotësimi, këtej e tutje, do të bëhet duke pasur parasysh këtë raport.

**Fatmir Xhafaj** – Normal, nëse iksi apo ypsiloni kanë ardhur nga radhët e jogjyqtarëve, për sa kohë që ky numër të jetë i plotësuar, ata do të konsiderohen pjesë e kësaj përqindjeje. Në momentin që ata do të largohen, do të zëvendësohen, është logjike. Pastaj, do të na krijonte disbalancime dhe do ta kishim të vështirë. Do të ndërhyjmë përsëri në ligj që të vendosnim ekuilibrat, siç bëjmë për rotacionin në Gjykatën Kushtetuese.

Në rregull me nenin 166, me ndryshimet që thamë.

Neni 167 “Dispozitat kalimtare për Gjykatën e Krimeve të Rënda”.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, ju, zoti kryetar, por edhe unë, në cilësinë e relatores, kemi marrë një letër, nuk e di të tjerët, nga kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda lidhur me këtë dispozitë kalimtare.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është reflektuar?

**Vasilika Hysi** – Jo, nuk është reflektuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk e di sa është njohur grupi i ekspertëve lidhur me...

**Fatmir Xhafaj** – Kam përshtypjen se ekspertët nuk e kanë marrë atë letër dhe do të duhet t’u japim kohë, pra ta votojmë në parim, por ta lëmë të hapur që të shihet. Nëse ka nevojë për ndryshim, atëherë të ndryshohet. Nëse nuk ka nevojë për ndryshim, le të miratohet. Në rregull?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit për mirëkuptimin!

Kështu që zonja Hysi, së bashku me ekspertët, me zonjën Agnes në krye të tyre, po të jetë e nevojshme të bëni edhe ndonjë konsultim me ata vetë.



Neni 168 “Dispozitat kalimtare për prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda”.

**Vasilika Hysi** – Personalisht nuk kam ndonjë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Por po ta shikoni, ka një trajtim të ndryshëm në lidhje me nenin 167.

**Fatmir Xhafaj** – Këtu kam një gjë, që Prokuroria e Posaçme do të ngrihet tërësisht si e re dhe ne nuk mund të bëjmë kalimin e prokurorëve aktualë të Krimeve të Rënda tek ajo e posaçme. “Prokuroria e Posaçme” është një status krejt tjetër. Gjykata nuk ka ndryshim nga statusi, pozicioni i saj me ligjin e ri ka shumë pak, kurse Prokuroria e Krimeve të Rënda është...

Kam përshtypjen se ka nevojë për riformulim.

Ata që nga ky moment i nënshtrohet emërimit si prokuror i zakonshëm. Kush fiton përzgjidhet për Prokurorinë e Posaçme. Në rregull, nuk kam...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Si të gjithë prokurorët e tjerë.

Këtu kemi një status krejt të ndryshëm, formatim të ndryshëm, përbërje të ndryshme, funksion të ndryshëm...

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje vetëm për zonjën Agnes, nëse do të më lejoni, zoti kryetar, për pikën 5. Këtu flitet për Prokurorinë e Posaçme dhe thuhet: “Në rast se mandati nëntëvjeçar i prokurorit në detyrë ka përfunduar, prokurori qëndron në detyrë edhe gjashtë muaj pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, me qëllim që këshilli të zgjedhë pasuesin e tij, me kusht që të përmbushë kriteret e paragrafit 1 dhe 2”.

Këtu flasim për një prokurori, e cila nuk është krijuar ende. Pra, këtu nuk është krijuar ende prokuroria. Kur thoni prokuroria e posaçme, keni parasysh Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe atë aktuale?

**Fatmir Xhafaj** - Kërkoj një mirëkuptim, do të dëshiroja që ky nen të diskutohej me grupin e drejtësisë penale me zotin Smajber, zotin Hoxha, zonjën Bumçi, së bashku me relatoren, nëse edhe ju zonja Agnes do të keni këtë mirëkuptim.

**Agnes Bernhard** *-(flet anglisht)* Ky është një propozim që vjen, në fakt edhe nga ai grup, është i gjithë formulimi, i cili është dhënë nga zoti Smajber dhe ne e kemi përfshirë këtu, por pasi të kemi diskutuar mbi ligjet që lidhen me SPAK-un duhet ta rishikojmë edhe një herë me qëllim që të sigurohet përputhshmëria.

**Fatmir Xhafaj** - Biem dakord.

Neni 169 “Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”.

**Vasilika Hysi** - Këtu ka vetëm një riformulim të paragrafit të dytë. “Ata vazhdojnë në detyrë, kalojnë procesin e rivlerësimit”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Miratohet.

Nenin 170 “Dispozitat kalimtare për ndihmësit ligjorë, jomagjistratë dhe inspektorët”.

**Vasilika Hysi** – Këtu ka riformulime dhe nuk ka pasur ndonjë ndryshim.

**Fatmir Xhafaj** - Jemi dakord me ndryshimet dhe riformulimet.

Miratohet.

Neni 171 “Dispozitat kalimtare për gjyqtarë dhe prokurorë të mëparshëm”.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka ndryshime, por janë thjesht riformulime.

Zoti kryetar, ka një gjë pozitive meqenëse duhet ta theksojmë, janë vënë disa kushte shumë pozitive në këtë ligj. Për shembull, shqetësimi që kolegët tanë e kanë ngritur në parlament, që nuk mund të jenë gjyqtarë dhe prokurorë personat që kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë, ose të favorizuar nga sigurimi i shtetit para viteve 1990, është i parashikuar në ligj, apo kanë qenë bashkëpunëtorë informatorë, agjentë të një shërbimi sekret, pra janë gjëra pozitive që janë vendosur në disa dispozita, sepse ka qenë një kërkesë nga një pjesë e mirë e grupit të kolegëve në Kuvend.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Do të doja të shtoja që në paragrafin 1 germa “b”, do të duhet që edhe kjo të jetë në harmoni me formulimin si në Kushtetutë.

**Fatmir Xhafaj** - Kam edhe unë një shqetësim, si do të trajtohet, për shembull një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese që vjen nga radhët e gjyqësorit, ose një njeri që ka qenë 9 vjet në Gjykatën Kushtetuese, do të vlerësohet për efekt të këtij ligji një njeri që ka punuar 9 vjet në Gjykatën Kushtetuese për të punuar në sistemin gjyqësor ndërkohë që ne do të përfshijmë ndihmesat, këshilltarët e të tjerë? Është goxha eksperiencë. Zakonisht këta i kemi vënë në mosha të reja. Nuk do të jetë luks për ne që t’i humbasim.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Sipas këtij drafti ne i kemi referuar një përvojë pune prej 10 vjetësh dhe jo 9, por kjo varet nga vendimi juaj për të vendosur se cili do të ishte numri më i mirë.

**Fatmir Xhafaj** - Për shembull në cilësinë e gjyqtarit? Zoti Zaganjori ka qenë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, shkoi në Gjykatë të Lartë, brenda sistemit, pjesa që ka shërbyer 9 vjet në Gjykatën Kushtetuese do të konsiderohet në cilësinë e gjyqtarit apo...

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*)Kjo është një pyetje se si ju do ta interpretoni termin e një “gjyqtari të mëparshëm” edhe brenda në Kushtetutë, sepse në Kushtetutë përcaktohet ky term, pra “gjyqtarët e mëparshëm”. Unë do të thosha se një gjyqtar i Gjykatës së Lartë është një gjyqtar si gjithë të tjerët. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të kenë nevojë për më shumë arsytim, për të thënë që edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë gjyqtarë në kuptimin e Kushtetutës, por përsëri kjo është një çështje që varet nga interpretimi që do t’i bëni Kushtetutës. Për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, nuk kam asnjë dyshim, që ata janë gjyqtarë, duke përfshirë edhe gjyqtarët e mëparshëm.

**Fatmir Xhafaj** - Jam dakord, po ka qenë gjyqtarë i Gjykatës së Lartë, është logjika që thoni ju, unë flas vetëm për të parë statusin që do të kenë në raport me pushtetin gjyqësor, ata që kanë qenë gjyqtarë kushtetues.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, kjo është një pikë që është diskutuar gjatë këto ditë, por kam një pyetje tjetër për zonjën Agnes, në paragrafin e parë ne kemi bërë një dallim, ku thuhet: “Personat të cilët janë diplomuar dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistratë, të paktën për 3 vjet”. Pjesa e parë e fjalisë. Pastaj vazhdojmë: “Ose kanë ushtruar funksionin për magjistratë për 10 vjet”. Unë nuk shoh ndonjë dallim për 3 dhe 10 vjet.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, ai është rasti që ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës, për shembull është rasti i atij djalit, nuk e di sesi e ka emrin...

**Vailika Hysi** – Terminologjia është e njëjtë këtu. Kanë ushtruar funksionin si magjistratë.

**Fatmir Xhafaj** – Personat të cilët janë diplomuar. Frazja janë diplomuar dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistratë.

**Vasilika Hysi** - Tre vjet.

**Fatmir Xhafaj** - E lidh me diplomimin. Janë dy kategori. Njëra është ajo që ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës dhe pa dyshim që do t’i lërë një numër më të vogël shërbimi, tre vjet, pavarësisht se është larguar. Për shembull, është rasti i atij që ka shkuar në Kanada për t’u bërë doktor i shkencave e të tjera dhe e ka zgjatur periudhën. Ai do të ketë të drejtën morale, ka

mbaruar Magjistraturën, të kthehet në Magjistraturë. Ai është bërë doktor atje dhe vjen më i përgatitur, mendoj unë.

**Vasilika Hysi** - Unë i kuptoj këto dy kategori, por mos duhet të shprehemi pak më mirë të themi: “Personat, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe kanë ushtruar funksionin si magjistratë për 3 vjet” për t’u dalluar nga këta të tjerët që vijnë nga Juridiku dhe nuk kanë Magjistraturën.

**Fatmir Xhafaj** – A mund ta ndani?

**Vasilika Hysi** – Po, edhe mund ta ndajmë.

**Fatmir Xhafaj** – Riformulojeni dhe ndërkohë shikoni pak statusin! Ndoshta duhet të flitet edhe me këta të grupeve të tjera, për statusin e gjyqtarit kushtetues, do të konsiderohet gjyqtar për efekt të këtij ligji apo jo?

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë kam edhe një shqetësim tjetër për gjyqtarin kushtetues, përveç statusit. Ne kemi folur për pagat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të prokurorëve dhe para se të mbyllim ligjin te kapitulli i përfitimeve...

**Fatmir Xhafaj** - Ata kanë ligj të veçantë.

**Vasilika Hysi** - Duhet të shikojmë se në çfarë raporti do të qëndrojnë pagat, të kemi një hierarki midis pagave dhe përfitimeve.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, sepse mund të qëllojë që një gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të marrë më shumë se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

**Vasilika Hysi** - Sipas parashikimit, ai merrte më shumë se kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** - Prandaj e kemi lënë diskutimin. Ju kemi lënë edhe ju relatorëve që të bashkoheni me relatorin tjetër, zotin Majko, me grupet e punës dhe të definoni.

Jemi dakord me nenin 171 me ndryshimet dhe çështjet që lamë të hapura për të diskutuar.

Nenin 172 “Dispozitat kalimtare për magjistratë të komanduar në struktura të tjera”

**Vasilika Hysi** - Nuk ka ndonjë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Miratohet.

“Dispozita kalimtare për inspektorët me statusin gjyqtar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë”.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka ndonjë gjë. Nuk e di nëse kanë kolegët?

Paragrafi i parë është që ata duhet të rivlerësohen, të konsiderohen magjistratë. Ushtrinë komplet mandatin, paragrafi i dytë.

Kam një pyetje për zonjën Agnes: pse mandati i inspektorëve shtohet të paktën me një vit nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji? Te paragrafi i dytë, fjalia e dytë, unë nuk jam dakord të thuhet megjithatë, por “në çdo rast mandati...”. Pse në çdo rast mandati i inspektorit duhet të shtohet? E kam vënë re në të gjitha dispozitat kalimtare.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë kanë bërë kaq shumë këta?

**Vasilika Hysi** – Unë nuk kam qenë pjesë e grupit të punës dhe nuk mund të flas dot.

**Fatmir Xhafaj** – Ndoshta ky është një pozicion personal, nëse ka një strukturë për të cilin nuk ushqej konsideratë në sistem, është struktura e Inspektoratit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë edhe në Prokurorinë e Përgjithshme, ndërsa në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka pasur të gjithë autoritetin dhe kompetencën ligjore për ta bërë këtë funksion. Në prokurori ka një veçori, sepse janë thjesht bartës, ka qenë një strukturë shumë e dobët, shumë fraxhile në raport me autoritetin e prokurorit të Përgjithshëm, kurse këta kanë pasur të gjithë hapësirën dhe detyrimin ligjor që ta bënin këtë. Sot shumë probleme që kemi, i kemi për shkak të këtyre. Cili është luksi që duhet t’u japim këtyre?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, nuk ua heqim statusin e gjyqtarit se janë gjyqtarë, por t’i lëmë automatikisht, t’i komandojmë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sikur nuk më shkon. Është një privilegj që nuk e meritojnë.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Ky parashikim e ka qëllimin për të mbajtur të dhënat institucionale, të paktën ata përgatisin disa standarde procedurale që do të realizohen ose prej të cilave do të përfitojë edhe institucioni i ri që do të ngrihet. Pra, është një periudhë 10- vjeçare e nevojshme të paktën për nivelin e atyre që tashmë kanë ndërmarrë inspektime. Në momentin kur mbaron mandati, ata mund të marrin edhe një periudhë tjetër, deri në tetë muaj ose njëvjeçare, sa të zëvendësohen. Pra, të garantohe mi se inspektimet do të vazhdojnë, që rekordet institucionale do të vazhdojnë nga një moment në momentin tjetër. Sigurisht që inspektorati i ri do të ketë nevojë për një numër shumë më të madh të inspektorëve, gjithsesi do të jetë një fazë rekrutuese për inspektorët e rinj, të cilët duhet të kenë kaluar përmes procesit të vlerësimit, do të duhet njëfarë kohe deri sa inspektorët e rinj të jenë rekrutuar plotësisht dhe deri në atë moment

do të na duhen disa njerëz për të vazhduar, do të na duhet një numër minimal shërbimesh shërbimesh inspektuese. Unë, personalisht, nuk është se e kam kontrolluar këtë aspektin pesëvjeçar. Ideja është se, në përfundim të mandatit të tyre, nuk do të shërbejnë edhe shumë gjatë në sistem.

**Vasilika Hysi** – Unë kam disa pikëpyetje lidhur me këtë pjesën e dispozitave kalimtare. Unë mund ta kuptoj shumë mirë faktin se kryetari i Gjykatës së Lartë do të ishte mirë të kishte një zgjatje të afatit, sepse është një figurë, ka shumë lëvizje, do të ketë proces vlerësimi, por, zoti kryetar, mua më shqetëson këtu fjalia e dytë, që sapo diskutuam, që edhe për një inspektor të thjeshtë, të paktën thuhet se shtyhet me një vit. Pra, presupozohet se mund të shtyhet edhe më shumë se një vit.

Njëkohësisht kam një pyetje, dhe nuk di argumentet në lidhje me atë që parashikohet në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij ligji.

**Fatmir Xhafaj** – Qartë, qartë! Dakord!

Unë mendoj se është e nevojshme që këtë ta rishikoni përsëri me grupin e punës. Ata mund të qëndrojnë në detyrë për të bërë lidhjen dhe për të transmetuar gjithë databazen, për ta administruar këtë fazë transitore. Në momentin kur krijohen institucionet e reja, ata thjesht duhet të vlerësohen si magjistratë.

**Vasilika Hysi** – Po bëj një pyetje: në rast se ai, me hyrjen në fuqi të ligjit, ka akoma edhe tri ditë mandat, pse duhet t’ia shtysh edhe një vit tjetër?

**Fatmir Xhafaj** – Pikërisht pra, këtë po them. Shikojeni këtë, që të vazhdojë deri në momentin e krijimit të institucionit të ri. Pastaj le ta çmojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëse do ta marrë inspektor. Nëse s’e merr inspektor, s’pranohet si inspektor, është Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, që do t’i gjejë vendin, që ta trajtojë si magjistrat atje ku i takon të emërohet si magjistrat, sipas ligjit në fuqi.

**Vasilika Hysi** – Po nga ana tjetër, edhe në paragrafin 4, këta komandohen direkt në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Unë nuk e di pse është vendosur kështu. Si mundet që një inspektor, aktualisht në detyrë, mund të komandohet në zyrën e inspektorit dhe konsiderohet i komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për të bërë vlerësimin.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, po. Ramë dakord që ta lëmë këtë afatin. Me krijimin, këshilli do ta vendosë vetë: do ta mbajë apo s’do ta mbajë. Të jemi më të qartë me këtë gjë. Jo t’u japim

atyre të drejtë automatike për këtë gjë. Dakord jam. Dakord me nenin 173, me këtë koncept, me këtë ndryshim.

Neni 174: “Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, këtu duhet të jemi pak të kujdesshëm, sepse këtu thuhet: përveç rasteve kur parashikohen ndryshe në këtë nen, të gjitha të drejtat e tyre zbatohen menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo. Prandaj thamë se do ta lidhim me nenin e mëparshëm, për kohën e hyrjes në fuqi e të tjera.

**Vasilika Hysi** – Kjo ka lidhje qoftë me kapitullin mbi pagat, qoftë me vetingun, me vlerësimin.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Dakord jam.

**Vasilika Hysi** – Do të doja më shumë informacion nga ekspertët.

**Fatmir Xhafaj** – Jam i bindur se edhe zonja Agnes do të bjerë dakord me ne këtu.

Në rregull, faleminderit!

**Përkthyesja** – Po, edhe zonja Agnes ra dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 174 për riformulim. Dakord.

Neni 175: “Dispozita kalimtare në lidhje me fazat e rekrutimit të kandidatëve magjistratë”.

**Vasilika Hysi** – Do të doja që këtë dispozitë ta linim të hapur, sepse të hënën kemi ligjin “Për qeverisjen”.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Aty është përfshirë edhe ligji i Shkollës së Magjistraturës. Duam të unifikojmë shumë mirë periudhat e rekrutimit. Ndoshta zonja Agnes e ka të qartë, por në rast se do të bëjmë një postim të hyrjes në fuqi të ligjit, çfarë do të bëhet me vitin akademik 2017-2018. Këto duhen saktësuar mirë me të gjitha ligjet e paketës.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Gjithsesi, unë jam i bindur se zonja Agnes e ka pasur në konsideratë. E miratojmë në parim. Nëse për efekt të atij ligji, do të ketë nevojë të ndryshohet, i rikthehemi para votimit në tërësi. Në rregull.

**Përkthyesja** – Edhe zonja Agnes ra dakord me të.

**Fatmir Xhafaj** – në rregull! Faleminderit!

Neni 176: “Dispozitat kalimtare për emërimet”.

**Vasilika Hysi** – Në fakt mua më duket sikur bie pak ndesh me atë çfarë është thënë në nenin 174. Sepse ne themi që, me hyrjen në fuqi të ligjit, fillojnë të drejtat e detyrimit e magjistratëve. Pra, për emërimet, lëvizjet paralele, ndërsa këtu thuhet se kjo fillon për vitin 2017 – 2018. Nuk e di sa saktë e kam kuptuar.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Agnes.

**Vasilika Hysi** – Pikërisht zbatimi i nenit 40 i projektligjit, i cili flet për emërimin e magjistratëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Pra, kriteret e reja do të zbatohen për magjistratët e 2017-2018-ës. Po për këta që mbarojnë në vitin 2016-2017, cilat kritere do të zbatohen?

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Nuk duhet të përmbushin këto kritere specifike, sepse... Në fakt, ky paragraf i referohet vlerësimit gjatë praktikës së tyre, dhe ata të cilët nuk janë caktuar akoma për këtë praktikë, në tre muajt në vijim nuk do t'i kenë vlerësimet. Pra, duhet të bëjmë kujdes që ata të mos diskriminohen, sepse nuk do t'i kenë këto përfitime, për aq kohë që ligji nuk ka hyrë akoma në fuqi.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 177: “Dispozita kalimtare për caktimin në pozicione”.

**Vasilika Hysi** – Neni 177 bën fjalë për zbatimin e nenit 42, që është “Betimi”. Këtu thuhet se kjo do të zbatohet pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit, e kjo është normale.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 178: “Dispozita kalimtare për transferimin dhe ngritjen në detyrë”.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*)Do të donim të bënim një propozim këtu: të përfshinim parashikimet transitore, të cilat mund të jenë pjesë e vlerësimit, duke specifikuar që nuk do të përfitojnë ata magjistratë, që nuk e kanë kaluar me sukses procesin e vetingut. Do të jenë vetëm ata gjyqtarë e magjistratë, që e kanë kaluar me sukses procesin e vetingut.

**Fatmir Xhafaj** – Shumë dakord!

Dakord edhe ju? Në rregull! Në rregull! Faleminderit!

Neni 178, me propozimin dhe sugjerimin e bërë.

Neni 179: “Dispozita kalimtare për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve”.

**Vasilika Hysi** – Unë do të doja t'i bëja një pyetje zonjës Agnes dhe grupit të ekspertëve, se përse kanë bërë këtë dallim në përfundimin e vlerësimeve të gjyqtarëve. Për momentin aktual Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në ç'fazë të vlerësimit është? Cilin vit po vlerëson?

**Fatmir Xhafaj** – Më mirë të mos pyesësh për këtë gjë.



**Vasilika Hysi** – jemi akoma te 2007-2009? Jemi në vitin 2016? Më vjen edhe rëndë kur e lexoj në këtë dispozitë kalimtare. Ky këshill, që s'ka bërë akoma detyrat e 2007-ës do të vazhdojë t'i bëjë këto derisa të krijohet këshilli i ri?

**Fatmir Xhafaj** – Jo vetëm kaq, por ata inspektorët, për shkak të kësaj merite të veçantë që kanë, duhet të promovohen.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Për momentin, këshilli po e mbaron procesin e vlerësimit për 2008-2008-ën. Me aq sa di, ata i kanë përfunduar të gjitha raportet, por duhen ndërmarrë edhe ca vendime të tjera nga ana e këshillit. Është faza e fundit e raundit për 2008-2009-ën, dhe tashmë kanë filluar me raundin tjetër 2009-2010. Pra është punë në proces e sipër. Pas këtij parashikimi, ideja është se në periudhën transitore këshilli do të vazhdojë me vlerësimet që tashmë kanë filluar, por do të duhet të kenë disa prioritete, sepse gjatë fazës së rivlerësimit, këshilli duhet të mbështesë organet e vlerësuese, për testimet e aftësive shumë të larta profesionale. Struktura e ligjit për vlerësimin, pra kolona për testimin profesional është në vijim dhe mbledhja e dokumenteve për vlerësimin duhet të bëhet nga këshilli. Pra, gjithçka vendoset përpara këshillit.

Në fazën transitore, gjatë procesit të vetingut, këshilli do të mbështesë kryesisht organet vlerësuese për rivlerësimin. Megjithatë, testimi për vlerësimin profesional shumë të lartë, është shumë i fortë. Normale që vetëm ata që nuk janë kompetentë do të largohen, por ky proces nuk do të ketë një notë vlerësuese, po për hir të këtij ligji do të na duhet edhe një notë vlerësuese.

Pra, sapo organi vlerësues do të ketë vendosur që ky gjyqtar vlen për këtë pozicion, atëherë dosja i kalohet këshillit, ndërsa këshilli pastaj, merr dosjen, e shqyrton dhe vendos notën përkatëse, që do të thotë se, në vitet në vijim këshilli do të vlerësojë të njëjtën periudhë vlerësuese, si dhe organi vlerësues. Më pas, parashikimi thotë se në vijim të këtij procesi këshilli do të fillojë të vlerësojë magistratët në kohën pas periudhës së rivlerësimit.

Pra, është shumë e rëndësishme për të ditur se periudha e rivlerësimit në ligjin e vetingut, është diçka që lëviz tre vite përpara periudhës së vetingut. Pra, le të themi se është bërë vlerësimi në 2017-ën. Periudha e vetingut do të jetë 2016, 2015 dhe 2014, që do të thotë se për këto tre vite ata do të kenë testimin profesional, dhe në vijim do të përcaktohet edhe nota vlerësuese nga këshilli. Periudha tjetër vlerësuese për këtë gjykatës do të jetë periudha 2017, 2018, 2019. Në vitin 2020. Pra, viti 2020 do të vlerësojë 3 vjetët e mëparshme. Dhe gjyqtari do të marrë vlerësimin për periudhën respektive. Është paksa e komplikuar, por shpresoj se ata që

janë në krye të këtyre parashikimeve do të dinë se çfarë do të bëjnë dhe do ta përcaktojnë. Do të ketë disa vite për gjyqtarët, kur ata nuk do të vlerësohen. Mendojmë se është më e zgjuar që të mbështesim fuqishëm periudhën e vlerësimit të vetingut dhe të aftësisë profesionale. Ne vlerësojmë që pas këtij vetingu dhe testimi të kemi një vlerësim të vijueshëm të mëvonshëm. Të mos u kthehemi përsëri gjërave që kanë kaluar tashmë.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 179 do të doja të uleshim dhe ta diskutonim më me qetësi dhe vëmendje, pasi periudhat që janë lënë këtu janë shumë të gjata dhe i bie që ne për 3 vjet, sikurse shpjegoi zonja Agnes, të mos kemi vlerësim të disa gjyqtarëve. Pra, ne miratojmë një ligj në vitin 2016 dhe themi që reforma në drejtësi është shumë e nevojshme, pastaj të krijojmë një hendek të madh në vlerësimin e tyre. Unë do të doja më shumë sqarime në raportin midis paragrafeve 3, 4 dhe 5 të nenit 179 që flet për vlerësimin etik të gjyqtarëve. Mënyra se si është shprehur është e vështirë për ta bërë më të qartë.

Njëkohësisht, unë kam një pyetje lidhur me paragrafët e tjerë, treguesit statistikorë dhe treguesit e seancave. Këtu thuhet se këto të dhëna do të përdoren në vlerësimet që do të bëhen pas vitit 2016. Jam dakord që për treguesit e seancave do të bëhen pjesë, por, nga ana tjetër, në qoftë se pas vitit 2016 për një pjesë të mirë të gjyqtarëve nuk do të kemi vlerësime, sepse ata do të kalojnë këtë rivlerësimin, nuk do të krijohet një hendek, dhe nuk do të arrijmë të bëjmë një vlerësim real në zbatim të ligjit? Ndërkohë te pjesa e vlerësimeve ne kemi thënë që ajo hyn në fuqi menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit. Nuk kemi lëmë ndonjë periudhë transitore lidhur me të drejtat, detyrimet e magistratëve.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Unë mendoj se është një keqkuptim. Do të ketë vlerësim të vazhdueshëm, kështu që këshilli do të mbarojë në vitet 2008-2009 dhe do të vazhdojë me vitet 2009-2010 në vijimësi, dhe paralelisht organi vlerësues do të fillojë të rivlerësojë. Pra, le të themi që organi vlerësues do të fillojë me vitin 2016 për grupin e parë të gjyqtarëve. Ata do të vlerësohen për vitin 2015, vitin 2014 dhe për vitin 2013. Këshilli, paralelisht me vlerësimin e rivlerësimit të viteve 2009-2010, duhet të mbështesë edhe organet vlerësuese për periudhën 2013, 2014, 2015. Dhe sapo procesi i vetingut të vendosë që ky gjykatës të mos hiqet, do të përcaktojnë notat vlerësuese për gjyqtarin që do ta mbajnë në detyrë. Pra, kjo vazhdon në mënyrë progresive. Pra, do të ketë një vlerësim progresiv. Më pas në vitin 2017 organi vlerësues do të vlerësojë një grup tjetër gjyqtarësh për periudhën 2016, 2015 dhe 2014 dhe paralelisht këshilli

duhet të vlerësojë të njëjtët gjyqtarë që janë nën vlerësim. Është një përpjekje e vazhdueshme vlerësuese.

**Fatmir Xhafaj** – ... në parim nëse ka diçka që meriton të rishihet, pasi të reflektoni mbi këtë komentimin që bëri zonja Agnes. Ne këtu jemi dhe para votimit në tërësi mund ta bëjmë. Dakord.

Neni 180. Dispozita kalimtare për procedimet disiplinore.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje, zoti kryetar. Këtu flitet për hetimet disiplinore të papërfunduara. Këto mund të jenë ose në dorë të Ministrisë së Drejtësisë të Inspektoratit të KLD-së ose në zyrën e prokurorit të Përgjithshëm. Këtu thuhet që duhet të përfundojë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, si dhe do t'u nënshtrohen procedurave dhe dispozitave të ligjit që është në fuqi. Pra, me ligjin e vjetër. Por në rast se do të vendosim për ndryshim të kohës, do të vazhdojnë që këto institucione të mbajnë në dorë hetimet disiplinore të filluara prej muajsh, apo ndoshta dhe vitesh...? Pse e keni lidhur pikërisht me këtë?

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Ka një periudhë tranzicioni të shkurtër dhe hetime të cilat kanë filluar në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë që duhet të përfundojnë sipas dispozitave të ligjit me të cilat i kanë filluar këto hetime. Por ka një kohë të shkurtër kohe. Për këtë arsye institucionet do të përfundojnë të shpejtojnë punët që të përfundojnë hetimet brenda kësaj periudhe. Sapo ministri i Drejtësisë paraqet kërkesën për të filluar një procedim disiplinor para këshillit, pasi hyn në fuqi ky ligj, atëherë do të zbatohet ky ligj. Por nëse në kohën kur ligji hyn në fuqi dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ka një procedim disiplinor, i cili është lënë pezull dhe ka filluar në bazë të ligjit të vjetër, ai duhet të përfundojë në bazë të ligjit të vjetër. Mendoj se është një kohë shumë e shkurtër, e cila parashikohet këtu dhe mendoj se është një kohë e arsyeshme. Pas 3 muajve të gjithë duhet të fillojnë të zbatojnë dispozitat e reja.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 181. Aktet nënligjore.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, lidhur me aktet nënligjore, detyrime ka Këshilli i Ministrave, këshillat, ku janë përcaktuar kohë të ndryshme, afate të ndryshme që është brenda 3 muajve nga krijimi i këshillave dhe brenda një viti nga krijimi i këshillit për një kategori tjetër aktesh. Duke pasur parasysh faktin që këshillat krijohen pas 8 muajve...

**Fatmir Xhafaj** – Ramë dakord që do ta përputhim hyrjen në fuqi të këtij ligji afërsisht me periudhën që fillojnë dhe këshillat. Ne kemi mundësi që t'u japim edhe kohën për të bërë

aktet nënligjore. Do të dëgjojmë dhe qeverinë sa kohë i duhet për aktet nënligjore që kanë të bëjnë me sistemin e pagave, shpërblimeve etj. Në parim biem dakord. Vetëm afatet mund të jenë të lëvizshme. Dakord.

Neni 182. Shfuqizimet dhe amendamentet.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 182 janë renditur një sërë ligjesh tek të cilat do të ketë ndryshime. Në përvojën e teknikës legjislativë këto duhet të jenë nisma ligjore më vete.

**Fatmir Xhafaj** – Për çfarë do të shfuqizohen kapituj të ligjit të KLD-së? Këto do të shfuqizohen tërësisht...

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar ne kemi në dorë 7 ligje. Secili ligji shfuqizon një pjesë të neneve. Te ligji i KLD-së përveç neneve që shfuqizon ky ligj ne duhet t'i mbledhim të gjitha dispozitat kalimtare të 7 ligjeve, sepse mund të ndodhë që ligji të bjerë komplet poshtë.

**Fatmir Xhafaj** – Poshtë do të bjerë.

**Vasilika Hysi** - Atëherë dikush nga grupi i punës duhet t'i përmbledhë, sepse në çdo ligj ka shfuqizime dhe amendime të dispozitave konkrete që lidhen me ligjin në fjalë. Po në të njëjtin ligj shfuqizohen dispozita të tjera. Pra, duhet bërë një listë...

**Fatmir Xhafaj** – Për shembull ligji aktual për prokurorinë shfuqizohet i tëri.

**Vasilika Hysi** – Për Shkollën e Magjistraturës nga grupi i ekspertëve është përfshirë edhe ligji i qeverisjes.

**Fatmir Xhafaj** – Ligji për Shkollën e Magjistraturës shfuqizohet i tëri. Të gjitha këto ligje shfuqizohen të tëra.

**Vasilika Hysi** – Për ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” kemi ligj të ri.

**Fatmir Xhafaj** –Përjashtoj ligjin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa të gjitha ligjet e tjera shfuqizohen.

**Agnes Bernhard** *-(flet anglisht)*Unë jam plotësisht dakord që ky projektligj ishte akoma i bazuar në idenë... Nëse është një iniciativë e veçantë ligjore atëherë duhet të riformulohet ndryshe, sepse në këtë rast i gjithë ligji shfuqizohet.

**Fatmir Xhafaj** – Të shihet neni 182 me shfuqizimet dhe amendamentet, me vendimmarrjen që do të kenë ligjet kuadër të paketës së reformës.

Nenin 183 e lamë të hapur për të përcaktuar hyrjen në fuqi.

Kështu e mbyllim të gjithë projektin. Natyrisht kemi lënë të hapur kapitullin që ka të bëjë me pagat dhe përfitimet, i cili është në diskutim për shkak se ne presim edhe opinionin e

Këshillit të Ministrave sipas detyrimit kushtetues. Ndërkohë ekspertët në bashkëpunim me relatore, nën kujdesin e zonjës Hysi, nën kujdesin e zonjës Bernhard, do të duhet të bëjnë rishikimin, reflektimin e të gjitha gjërave çfarë kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord që duhet të ndryshohen nën pas nëni në këtë projekt, në mënyrë që atje ku ne i kemi shqyrtuar dispozitat t'i kemi të pastruara.

Dakord.

Falemnderit, zonja Bernhard! Nuk do të lodhem asnjëherë duke të thënë falemnderit!

Falemnderit dhe ekipit që ka punuar me ju! Një falënderim të veçantë dua ta jap për zonjat e nderuara që keni ju në krah, zonjën Vogli, bashkëpunëtoren tuaj dhe zonjën Saliu, e cila me modestinë e saj vazhdon dhe na surprizon të gjithëve.

Falemnderit dhe ekipit tonë mbështetës! Falemnderit stafit teknik, përfshirë edhe përkthimin!

Si gjithmonë relatorja e meriton një falënderim të veçantë, si qershia mbi tortë!

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*